

# STRATEGJIA INSTITUCIONALE



## KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

2022 - 2025



KOMISIONERI PËR TË DREJTËN  
E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN  
E TË DHËNAVE PERSONALE



Funded by the  
European Union



GARANTE  
PER LA PROTEZIONE  
DEI DATI PERSONALI

# PËRMBAJTJA

1. HYRJE.....	2
2. VIZIONI DHE MISIONI .....	2
3. E DREJTA PËR INFORMIM.....	2
3.1 SITUATA AKTUALE .....	2
3.2 OBJEKTIVAT.....	2
4. MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE.....	2
4.1 SITUATA AKTUALE .....	2
4.2 OBJEKTIVAT.....	2
5. LLOGARIDHËNIA, RAPORTIMI DHE MONITORIMI.....	2
6. FINANCIMI I STRATEGJISË.....	2
7. PLANI I VEPRIMIT STRATEGJIK .....	2

# 1. HYRJE

Strategjia Institucionale 2022-2025 (në vijim “Strategjia”) e Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Zyra e Komisionerit”) është hartuar duke marrë në konsideratë kuadrin ligjor ekzistues dhe procesin e modernizimit të tij në të dy fushat e përgjegjësisë. Gjithashtu, ky dokument ka vlerësuar raportet dhe rekomandimet e organizmave evropiane e ndërkombëtare, të cilat asistojnë dhe/ose mbështesin shtetin shqiptar për arritjen e standardeve bashkëkohore në zhvillimin ekonomik-shoqëror të vendit.



Strategjia identifikon vizionin dhe misionin e Zyrës së Komisionerit, objektivat për secilën fushë, si dhe masat e aktivitetet konkrete që do të realizohen në këtë periudhë.

Strategjia shoqërohet gjithashtu nga Plani i Veprimit 2022-2025, i cili shërben si një instrument programimi dhe monitorimi i aktiviteteve për përmbushjen e çdo objekti të parashikuar në këtë Strategji. Përmbushja e tyre ka si qëllim rritjen e nivelit të ushtrimit në praktikë të të drejtave kushtetuese nëpërmjet zbatimit të standardeve më të larta rregullatore në fushën e të drejtës për informim dhe atë të mbrojtjes së të dhënave personale.



Strategjia është hartuar me asistencën e ekspertëve të Projektit të Binjakëzimit “Mbështetje institucionit për përafrimin e legjislacionit mbi mbrojtjen e të dhënave personale me *acquis-in* e Bashkimit Evropian”. Ky Projekt u financua nga Bashkimi Evropian në kuadër të Instrumentit të Asistencës së Para-anëtarësimit, IPA 2017 dhe u zbatua nga konsorciumi i përbërë nga Autoriteti Italian për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (Autorità Garante per la Protezione dei Dati Personali), instituti austriak “Për të drejtat e njeriut dhe liritë themelore Ludëig Boltzmann”, me mbështetjen e CSI-Piemonte në Itali.

## 2. VIZIONI DHE MISIONI

### VIZIONI

Vizioni i Zyrës së Komisionerit është promovimi i një shoqërie që mban si vlera thelbësore garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, mbrojtjen e të dhënave personale dhe të drejtës për informim, në funksion të transparencës, përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies.



### MISIONI

Misioni ynë është monitorimi dhe mbikëqyrja e zbatimit të kuadrit ligjor për të siguruar ushtrimin efektiv të të drejtave në epokën digjitale duke nxitur autoritetet publike dhe kontrolluesit publikë e privat në ndërtimin e besimit reciprok me qytetarët, i cili sjell përmirësimin e mentalitetit dhe kulturës së shoqërisë në respektim të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Krijimi dhe funksionimi i autoritetit prej vitit 2008 ka ndikuar në njohjen dhe ndërgjegjësimin në rritje për ushtrimin e të këtyre të drejtave kushtetuese nga qytetarët. Nga ana tjetër, zbatueshmëria e legjislacionit nga autoritetet publike dhe kontrolluesit publik/privat ka dhënë rezultate të matshme. Njëkohësisht, janë konstatuar problematika, të cilat adresohen nëpërmjet reformës së kuadrit rregullator, rritjes së kapaciteteve administrative e buxhetore të Zyrës së Komisionerit dhe zgjerimit të edukimit të publikut.

Sfidë e institucionit është, gjithashtu, forcimi i bashkëpunimit dhe ndërveprimit me aktorë e grupe interesi, që standardet dhe normat rregullatore të kthehen në mundësi për garantimin e të drejtave dhe jo arsye për t'i kufizuar apo shmangur ato. Në këtë Strategji janë parashikuar objektiva konkret e të realizueshëm, të cilët shkojnë në përputhje jo vetëm me akte kombëtare (Kushtetuta, legjislacioni në fuqi, Rezolutat e Kuvendit, Strategji ndërinstytucionale, etj), por edhe me rekomandimet e dokumenteve evropiane dhe/ose ndërkombëtare, si dhe në përputhje me nevojat e konstatuara gjatë zbatimit në praktikë të legjislacionit në fuqi.

Secili prej këtyre objektivave do të realizohet nëpërmjet aktiviteteve, iniciativave dhe masave specifike, të cilat do të monitorohen nga tregues të qartë. Produktet e arritura do të pasqyrohen në raportime periodike, si dhe në Raportet Vjetore të veprimtarisë së Zyrës së Komisionerit.


## 3. E DREJTA PËR INFORMIM

### 3.1 SITUATA AKTUALE

Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, garantimi i kësaj të drejte ka njohur përmirësim të vazhdueshëm, duke ndikuar në rritjen e transparencës, llogaridhënies dhe integritetit të autoriteteve publike.

Transparenca proaktive nëpërmjet realizimit të instrumentit të Programit të Transparencës, ka ndikuar që sot qytetarët të kenë qasje në një sasi të madhe informacioni publik, cilësia e të cilit vjen duke u përmirësuar. Zyra e Komisionerit në përmbushje të detyrave ligjore ka konstatuar përmirësim të transparencës proaktive për një numër të konsiderueshëm autoritetesh publike. Zbatimi i kësaj të drejte renditet në krye të ecurisë së parimeve të Reformës në Administratën Publike për fushën e llogaridhënies. Në raportin e monitorimit të SIGMA për Shqipërinë për vitin 2021, vlera për treguesin “Qasja në informacionin publik” është në rritje, krahasuar me vlerësimin e mëparshëm të kryer në vitin 2017. Në lidhje me këtë progres, SIGMA ndalet ndër të tjera edhe në rolin e Zyrës së Komisionerit, duke vlerësuar pozitivisht përpjekjet e institucionit në promovimin e transparencës. Gjithashtu, institucioni ka zhvilluar trajnime të vazhdueshme për përfaqësuesit dhe koordinatorët e të drejtës për informim të autoriteteve publike, me qëllim forcimin e kapaciteteve për përmbushjen e detyrimeve ligjore.

Veprimtaria monitoruese dhe mbikëqyrëse e Zyrës së Komisionerit është zgjeruar në raport të drejtë me numrin e ankesave dhe angazhimin e autoriteteve publike për plotësimin e detyrimeve në kuadër të transparencës proaktive. Gjatë këtyre viteve, ka një tendencë në rritje të numrit të ankesave drejtuar nga qytetarët, shoqëria civile dhe grupet e interesit (media investigative). Në vlerësimin e Zyrës së Komisionerit, ky tregues nënkupton se është rrjedhojë e iniciativave ndërgjegjësuese, njohjes me të mirë të legjislacionit dhe besimit të shtuar në veprimtarinë e ushtruar nga institucioni.





Një nga elementet e qasjes ndërgjegjëse për ushtrimin e kësaj të drejte, por sidomos për maturimin e kapaciteteve të administratës, është përfshirja në kurrikulën e Shkollës Shqiptare të Administratës Publike (ASPA) të legjislacionit të të drejtës për informim. Në kuadër të ndërgjegjësimit dhe promovimit të saj, Zyra e Komisionerit ka bashkëpunuar aktivisht edhe me të gjithë individët/organizatat dhe autoritetet publike që udhetojnë të drejtën për informim. Konsolidimi institucional dhe pjesëmarrja aktive në marrëdhëniet ndërkombëtare solli përmbushjen e synimit të anëtarësimit të Zyrës së Komisionerit në Komitetin Ekzekutiv të Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit (ICIC). Kjo organizatë përbën platformën qendrore globale për nxitjen e transparencës dhe integritetit të autoriteteve publike.

Vitet e fundit institucioni është angazhuar intensivisht për realizimin e përmirësimeve të legjislacionit kryesor të fushës së të drejtës për informim. Ky proces ka mbajtur në konsideratë problematikat e konstatuara gjatë zbatimit të tij, por edhe sugjerimet/propozimet e vazhdueshme të grupeve të interesit. Zyra e Komisionerit hartoi projektligjin *“Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 119, datë 14.09.2014 “Për të drejtën e informimit”*, i cili pritet të miratohet brenda vitit 2022. Autoriteti vlerëson se këto përmirësime do të ndikojnë ndjeshëm në aksesin më të madh të qytetarëve në informacionin/dokumentacionin publik, konsolidimin e kompetencave mbikëqyrëse të institucionit dhe forcimin e rolit të koordinatorit. Këto ndryshime duhen parë edhe në optikën e reduktimit të hapësirave për korrupsion në administratën publike. Ushtrimi i kësaj të drejte në mënyrë proaktive është një nga shtyllat kryesore të mirëfunksionimit të shtetit ligjor.

Paralelisht, për modernizimin e kuadrit rregullator Shqipëria hodhi hapa konkret për arritjen e standardeve bashkëkohore në këtë fushë, duke inkuadruar në legjislacionin kombëtar Konventën e Këshillit të Evropës nr. 205/2009 (KiE) *“Mbi aksesin në dokumentet zyrtare”* me miratimin e ligjit nr. 45/2022 *“Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës “Për aksesin në dokumentet zyrtare”*”. Po ashtu, Kuvendi i Shqipërisë miratoi edhe ligjin nr. 33/2022 *“Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”*, i cili përaftron Direktivën 2019/1024 të BE me të njëjtën emërtesë. Të dy këto akte ligjore kanë për qëllim plotësimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të fushës së të drejtës për informim dhe forcimin e garancive për aksesin e qytetarëve në informacionin/dokumentacion zyrtar. Përafrimi i tyre në kuadrin rregullator shqiptar është një mundësi për pjesëmarrjen e qytetarëve në mirëqeverisje dhe një shprehje e ushtrimit efektiv të demokracisë përfaqësuese.

Me përfundimin e procesit të ratifikimit të Konventës 205/2009 të KiE, Zyra e Komisionerit do të jetë përfaqësuese në Këshillin e Palëve. Përsa i përket transpozimit të Direktivës 2019/1024 të BE, krijohen standardet e domosdoshme për përdorimin e të dhënave të hapura, me synimin për nxitjen e inovacionit në ofrimin e shërbimeve dhe produkteve. Zyra e Komisionerit, në zbatim të ligjit nr. 33/2022, është përgjegjëse për mbikëqyrjen e së drejtës për ripërdorimin e dokumenteve zyrtare dhe shqyrtimin e ankesave në rastet e cenimit të saj.

## 3.2 OBIJEKTIVAT

Në fushën e të drejtës për informim, objektivat kryesorë për këtë periudhë janë:

**OBJEKTIVI 1:** Përmirësimi i kuadrit ligjor në fushën e të drejtës për informim në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Përbushja e këtij objektivi do të realizohet nëpërmjet këtyre aktiviteteve:

- ✓ Miratimi i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 119, datë 14.09.2014 “Për të drejtën e informimit” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.
- ✓ Zbatimi efektiv i ligjit nr. 33/2022 “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik” si dhe miratimi i akteve nënligjore në zbatim të tij.
- ✓ Forcimi i kapaciteteve të stafit të Zyrës së Komisionerit mbi zbatimin efektiv të kuadrit të modernizuar ligjor.
- ✓ Ofrimi i mbështetjes praktike për autoritetet publike mbi zbatimin e kuadrit të ri rregullator të fushës.

**OBJEKTIVI 2:** Komunikimi proaktiv për konsolidimin e kulturës së transparencës të autoriteteve publike.

Përbushja e këtij objektivi do të realizohet nëpërmjet këtyre aktiviteteve:

- ✓ Forcimi i rolit të koordinatorit për të drejtën e informimit.
- ✓ Orientimi i autoriteteve publike në qartësimin e çështjeve me interes publik dhe rasteve të kufizimit të dhënies së informacionit, sidomos, përdorimin e konceptit të konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale.
- ✓ Përfshirja në Indeksin e Transparencës të një numri sa më të madh të autoriteteve publike në nivel qendror dhe të varësisë.
- ✓ Verifikimi i nivelit të transparencës së institucioneve publike qendrore, të varësisë dhe atyre të vetëqeverisjes vendore.

**OBJEKTIVI 3:** Bashkëpunimi me qytetarët dhe grupet e interesit për njohjen e kuadrit të modernizuar ligjor dhe rritjen e ndërgjegjësimit me qëllim zbatimin efektiv të tij.

Përbushja e këtij objektivi do të realizohet nëpërmjet këtyre aktiviteteve:

- ✓ Zhvillimi i iniciativave ndërgjegjësuere me qëllim njohjen e publikut, shoqërisë civile, grupet e interesit dhe median me kuadrin e ri rregullator.
- ✓ Zhvillimi i trajnimeve për zbatimin e të drejtës për informim me fokus brezin e ri në bashkëpunim me institucione të arsimit të lartë në gjithë vendin.

- ✓ Dhënie kontributi me ekspertizë teknike që u nevojiten aktorëve të shoqërisë civile, për të përçuar më tej rolin e tyre si watchdog të transparencës dhe aksesit në informacion.
- ✓ Realizimi dhe publikimi periodik në faqen zyrtare të Zyrës së Komisionerit të materialeve informuese dhe përdorimi i platformave të ndryshme komunikuese.

**OBJEKTIVI 4:** Zhvillimi dhe zgjerimi i marrëdhënieve ndërkombëtare brenda komunitetit global rregullator të të drejtës për informim.

Përbushja e këtij objekti do të realizohet nëpërmjet këtyre aktiviteteve:

- ✓ Organizimi i edicionit të 15 të Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit (*International Conference of Information Commissioners-ICIC*).
- ✓ Dhënia e kontributit në cilësinë e përfaqësuesit në Këshillin e Palëve të Konventës së Këshillit të Evropës “Për aksesin në dokumente zyrtare”.
- ✓ Veprimtari aktive në grupet/bordet e punës të Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve për të Drejtën e Informimit (ICIC), duke punuar ngushtë me partnerët dhe institucionet homologe
- ✓ Zgjerim i bashkëpunimit me autoritetet homologe për shkëmbimin e eksperiencave dhe praktikave më të mira.




## 4. MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE

### 4.1 SITUATA AKTUALE

Në ekonominë e sotme globaliste zhvillimi i teknologjive inovative ka sjellë qarkullim masiv të informacionit dhe rrjedhimisht, rritjen e fluksit të përdorimit të të dhënave personale duke transformuar gjithnjë e më shpejt shoqërinë drejt digjitalizimit.

Kuadri rregullator shqiptar i fushës përbëhet nga ligji nr. 9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij. Si pjesë e veprimtarisë mbikëqyrëse të Zyrës së Komisionerit, është ndjekur qasje proaktive në aspektin parandalues në plotësimin e detyrimeve ligjore të kontrolluesve publik e privat. Autoriteti konstaton rritjen e bashkëpunimit me ta edhe pse, vlerëson se ka ende vend për angazhim më serioz për arritjen e standardeve të kërkuara për garantimin e kësaj të drejte themelore kushtetuese. Veçanërisht, rastet e cenimit dhe përhapjes masive të informacionit personal të qytetarëve treguan dobësi të theksuara të strukturave dhe sistemeve që i administrojnë ato. Koha në të cilën jetojmë na detyron marrje e masave më largpamëse, ligjore, infrastrukturë të sigurt dhe integritet më të lartë, për të adresuar problematikat e konstatuara në minimizimin e mundësive të përsëritjes së tyre.

Zyra e Komisionerit ka administruar gjatë viteve të fundit një numër në rritje të ankesave, çka përbën ndërgjegjësim në rritje të qytetarëve për ushtrimin në praktikë të kësaj të drejte. Por, analizimi krahasimor i situatës, tregon se përgjegjësitë në ushtrimin e detyrave dhe funksioneve nga kontrolluesit, si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat, janë ende në nivel të ulët dhe shpesh fiktive.



Ashtu si edhe në fushën e të drejtës për informim, legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale është përfshirë në kurrikulën e Shkollës Shqiptare të Administratës Publike (ASPA) për të gjithë nëpunësit, me synimin e zgjerimit të aspektit ndërgjegjësues jo vetëm për qytetarët. Nga ana tjetër, është forcuar bashkëpunimi me grupet e interesit për të arritur qëllimin e garantimit të ushtrimit praktik të të drejtave nga individët. Në marrëdhëniet me jashtë roli i Zyrës së Komisionerit është aktiv në të gjitha forumet evropiane e ndërkombëtare, për identifikimin dhe marrjen e praktikave më të mira dhe forcimin e kapaciteteve institucionale për zbatimin e tyre sipas standardeve bashkëkohore.

Legjislacioni në fuqi i kësaj fushe është i përafuar në mënyrë të plotë me Direktivën 95/46 të BE “Për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin e të dhënave personale dhe qarkullimin e lirë të të dhënave të tilla”. Hyrja në fuqi më 25 maj 2018 e Rregullores së BE 2016/679 “Për mbrojtjen e personave fizikë lidhur me përpunimin e të dhënave personale dhe për lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave” (GDPR), shfuqizoi këtë Direktivë. Synimi i GDPR është zgjerimi dhe përmirësimi i garancive për mbrojtjen e të dhënave personale, në një kohë kur nga zhvillimi teknologjik përpunimi i tyre është shumëfishuar. Kjo reformë rregullatore përfshin edhe modernizimin e proceseve përpunuese në kuadër të veprimtarisë dhe bashkëpunimit të organeve ligjzbatuese në fushën penale, me miratimin e Direktivës së Policisë dhe shfuqizimit të vendimit kuadër 2008/977/JHA.

Për shkak të rëndësisë së kësaj reforme dhe domosdoshmërisë që qytetarëve shqiptarë t’u garantohen të njëjtat standarde evropiane për mbrojtjen e të dhënave personale, Zyra e Komisionerit intensifikoi hapat për përafrimin e legjislacionit në fuqi me GDPR dhe Direktivën e Policisë. Kjo iniciativë u realizua me mbështetjen e Projektit të Binjakëzimit, duke u finalizuar me projektligjin “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i cili pritet të miratohet brenda vitit 2022. Njëkohësisht, u punua për përmirësimin e 13 akteve nënligjore në zbatim të tij. Modernizimi i legjislacionit kombëtar të kësaj fushe vjen i harmonizuar me *acquis* të BE dhe përbën zhvillim në realizimin konkret të një prej kriterëve në procesin e integritetit të vendit për anëtarësim në këtë organizëm.

Njëkohësisht, për të qënë komplementare me GDPR, u finalizua modernizimi i Konventës së Këshillit të Evropës (KiE) “Për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale” me *Protokollin ndryshues ETS nr. 223* në maj 2018 (Konventa 108+). Si vend anëtar i KiE, por edhe nga rekomandimet e dhëna nga Progres Raporti i Komisionit Evropian ndër vite, Shqipëria ratifikoi Konventën 108+ me miratimin e ligjit nr. 49/2022 “Për ratifikimin e *Protokollit Ndryshues të Konventës “Për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale”*”. Miratimi i këtyre dy akteve, e rendit Shqipërinë në grupin e vendeve të kontinentit evropian me legjislacion bashkëkohor në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, çka përbën për institucionin sfidë për zbatimin e tij integral.

## 4.2 OBIJEKTIVAT

Në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale objektivat kryesorë për këtë periudhë janë:

**OBJEKTIVI 1:** Arritja e standardeve më të larta rregullatore për të forcuar mbrojtjen e të dhënave personale në epokën digjitale.

Përbushja e këtij objektivi do të realizohet nëpërmjet këtyre aktiviteteve:

- ✓ Miratimi i projektligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i përafuar me *acquis* të BE në këtë fushë dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.
- ✓ Miratimi i projektligjit “Për krijimin e Regjistrisë së komunikimeve tregtare të pa kërkuara”;
- ✓ Promovimi i qasjes së re të kontrolluesëve dhe përpunuesëve në procesin e përpunimit të të dhënave personale me qëllim garantimin më efektiv të sigurisë së informacionit;
- ✓ Nxitja e përgjegjshmërisë së kontrolluesve publik për t’iu drejtuar gjithnjë Zyrës së Komisionerit për dhënien e mendimeve për projekt aktet, ligjore dhe nënligjore, që kanë të bëjnë me të dhënat personale, si dhe projektet që kërkohen të zbatohen nga kontrolluesit vetëm apo në bashkëpunim me të tjerë.

**OBJEKTIVI 2:** Rritja e kapaciteteve institucionale në kuadër të përmirësimeve ligjore, me fokus të veçantë sistemet e sigurisë së menaxhimit të informacionit (SMSI).

Përbushja e këtij objektivi do të realizohet nëpërmjet këtyre aktiviteteve:

- ✓ Propozimi i ndryshimeve strukturore të Zyrës së Komisionerit në funksion të kompetencave dhe detyrave të reja që burojnë nga legjislacioni i ri për mbrojtjen e të dhënave personale.
- ✓ Pjesëmarrja e stafit në iniciativat dhe rrjetet teknologjike ndërkombëtare dhe evropiane me qëllim përmirësimin e aftësive të tyre në këtë drejtim.
- ✓ Identifikimi dhe garantimi i sigurisë teknike në kontrollues publikë dhe privatë me qëllim ruajtjen e konfidencialitetit, integritetit, disponueshmërinë dhe besueshmërinë e sigurisë së informacionit në procesin e përpunimit të të dhënave personale.
- ✓ Krijimi i Rrjetit të nëpunësve për mbrojtjen e të dhënave personale në sektorin publik dhe privat dhe promovimi i dialogut me ta.

**OBJEKTIVI 3:** Rol aktiv në ndërgjegjësimin dhe promovimin e të drejtave të qytetarëve me fokus, edukimin e brezit të ri.

Përbushja e këtij objektivi do të realizohet nëpërmjet këtyre aktiviteteve:

- ✓ Organizime periodike të trajnimeve, workshop-e me qëllim rritjen e aftësive të kontrolluesve/përpunuesve në zhvillimin me përgjegjshmëri të proceseve përpunuese të të dhënave personale të qytetarëve.

- ✓ Promovimi i legjislacionit të ri të fushës në sistemin arsimor të vendit, me programe të dedikuara për të gjitha grupmoshat, veçanërisht, për personat më të rrezikuar ndaj ekspozimit të përhapjes së të dhënave personale, siç janë fëmijët dhe të rinjtë.
- ✓ Përcjellja e njohurive të thelluara akademike për shtimin e numrit të ekspertëve/profesionistëve në këtë fushë nëpërmjet bashkëpunimit me institucionet e arsimit të lartë, Shkollën e Magjistraturës dhe Shkollën Shqiptare të Administratës Publike.
- ✓ Hartimi i materialeve ndërgjegjësuese për promovimin e kulturës në ushtrimin e kësaj të drejte nga qytetarët.

**OBJEKTIVI 4:** Forcimi i bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtarë për shkëmbimin e përvojave më të mira, me fokus risitë që sjell zbatimin e legjislacionit të harmonizuar.

Përbushja e këtij objektivi do të realizohet nëpërmjet këtyre aktiviteteve:

- ✓ Zgjerimi i bashkëpunimit me autoritetet homologe dhe/ose organizmat ndërkombëtare për projekte në kuadër të shkëmbimit të praktikave/standardeve më të mira në këtë fushë.
- ✓ Forcimi i kapaciteteve administrative në shqyrtimin e praktikave në lidhje me transferimin ndërkombëtar të të dhënave personale.
- ✓ Konsolidimi i marrëdhënieve, shkëmbimit të eksperiencave dhe njohurive praktike në kuadër të ligjit nr. 113/2018 "Për ratifikimin e marrëveshjes për bashkëpunimin ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Eurojust-it".
- ✓ Pjesëmarrje aktive në forume e iniciativa për promovimin e dialogut ndërkombëtar për mbrojtjen e të dhënave dhe privatësisë.

## 5. LLOGARIDHËNIA, RAPORTIMI DHE MONITORIMI

Në përputhje me Regulloren e Brendshme të Zyrës së Komisionerit procesin e monitorimit të zbatimit të Strategjisë Institucionale 2022-2025 dhe Planit të Veprimit e administron Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS). Ky mekanizëm institucional mbledh dhe analizon periodikisht nga strukturat përgjegjëse rezultatet, problematikat e konstatuara dhe vlerëson progresin e zbatimit të objektivave të Strategjisë çdo 6 muaj dhe në bazë vjetore.

Në funksion të pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse, Zyra e Komisionerit fton të kontribuojnë në zbatimin e Strategjisë edhe qytetarë, organizata të shoqërisë civile, grupe interesi dhe donatorë vendas e të huaj. Ky bashkëveprim realizohet nëpërmjet ngritjes së grupeve monitoruese, sipas fushës së përgjegjësive, të cilët do të funksionojnë si forume konsultative.

GMS mund të vendosë për përmirësimin e objektivave/masave në funksion të përmbushjes së plotë të qëllimit të kësaj Strategjie, duke synuar harmonizimin e saj në funksion të zhvillimeve në të dy fushat e përgjegjësive së institucionit. Njëkohësisht, do të rishikohen nevojat financiare dhe jo vetëm, për realizimin e këtij dokumenti, duke planifikuar saktë resurset dhe risqet në kuadër të Programit Buxhetor Afatmesëm.

Plani i Punës dhe buxheti vjetor i Zyrës së Komisionerit do të reflektojnë objektivat e kësaj Strategjie, të cilat do të zërthehen në aktivitete më konkrete afatshkurtër.

GMS harton Raportin periodik 1-vjeçar të monitorimit të zbatimit të Strategjisë, i cili publikohet në faqen zyrtare të internetit të Zyrës së Komisionerit.

## 6. FINANCIMI I STRATEGJISË

Financimi i Strategjisë Institucionale 2022-2025 të Zyrës së Komisionerit do të realizohet nga dy burime kryesore, buxheti i shtetit të akorduar për Zyrën e Komisionerit për këtë periudhë dhe/ose mbështetja e donatorëve të vendas e të huaj.

Efektet financiare të zbatimit të këtij dokumenti janë përlllogaritur nga përvoja e akumuluar nga institucioni ndër vite dhe planifikimi i përgjegjshëm për aktivitetet e programuara në mënyrë të detajuar në Planin e Veprimit 2022-2025. Ky program financiar shoqërohet me një kostim analitik të secilës masë dhe me afate konkrete për realizimin e tyre.



## 7. PLANI I VEPRIMIT STRATEGJIK

PLAN I VEPRIMIT 2022-2025						
E DREJTA PËR INFORMIM						
Nr.	Aktiviteti në zbatim të objektivave specifike	Struktura/t përgjegjëse	Data e fillimit	Data e mbarimit	Kosto Indikative (në mijë lekë)	Produkti
<b>OBJEKTIVI 1:</b> Përmirësimi i kuadrit ligjor në fushën e të drejtës për informim në përputhje me standardet ndërkombëtare.						
1.	Miratimi i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 119, datë 14.09.2014 “Për të drejtën e informimit” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.	Zyra e Komisionerit	6 / II 2022	6 / II 2023	Kosto Administrative	Ligji për të drejtën e informimit, i ndryshuar, i miratuar brenda 2022.  Akte nënligjore të miratuara brenda 2023.
2.	Zbatimi efektiv i ligjit nr. 33/2022 “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik” si dhe miratimi i akteve nënligjore në zbatim të tij.	Zyra e Komisionerit	6 / I 2023	6 / II 2025	Kosto Administrative	5 akte nënligjore të miratuara.  Aktivitete ndërgjegjësuese mbi promovimin e të drejtës për ripërdorim të dokumenteve sipas këtij ligji.  Ankesa me objekt cenimin e të drejtës për ripërdorim të dokumenteve të shqyrtuara nga Zyra e Komisionerit.

3.	Forcimi i kapaciteteve të stafit të Zyrës së Komisionerit mbi zbatimin efektiv të kuadrit të modernizuar ligjor.	Zyra e Komisionerit	6 / II 2022	6 / II 2023	Kosto Administrative  Asistencë teknike EUD nëpërmjet fondeve IPA 2020 për Mirëqeverisjen	Projekt i përfituar nëpërmjet fondeve IPA 2020 për Mirëqeverisjen, i zbatuar.  Zbatim efektiv i ligjit nr. 45/2022 “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës mbi Aksesin në Dokumente Zyrtare”.  Zbatim efektiv i ligjit nr. 33/2022 “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”.  Rritje e performancës në trajtimin e ankesave në zbatim të ligjit nr.33/2022.  Rritje e performancës në trajtimin e kërkesave për informacion në zbatim të ligjit për të drejtën e informimit.
4.	Ofrimi i mbështetjes praktike për autoritetet publike mbi zbatimin e kuadrit të rregullator të fushës.	Drejtoria e Përgjithshme e të Drejtës për Informim	6 / I 2023	6 / II 2025	Kosto Administrative  Donatorë	Sesione informuese të zhvilluara me koordinatorët e të drejtës për informim të AP në nivel qendror dhe vendor;  Trajnime të nëpunësve civil të organizuara në bashkëpunim me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike mbi risitë dhe mënyrën e trajtimit të kërkesave për informacion si dhe zbatimin e detyrimeve të ligjit për të drejtën e informimit.  Takime ndërgjegjësuese në nivel Këshilli Qarku, me përfaqësues të AP qendrore dhe NJVV mbi programet e transparencës

						<p>dhe detyrimet të cilat burojnë nga ligji për të drejtën e informimit.</p> <p>Aktivitete ndërgjegjësuese/workshop/trajnime të organizuara mbi mënyrën e trajtimit të kërkesave për informacion në zbatim të ligjit nr.33/202 “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik” dhe detyrimet në zbatim të tij;</p>
<b>OBJEKTIVI 2:</b> Komunikimi proaktiv për konsolidimin e kulturës së transparencës të autoriteteve publike.						
1.	Forcimi i rolit të koordinatorit për të drejtën e informimit.	Drejtoria e Përgjithshme e të Drejtës për Informim	6 / II 2022	6 / II 2025	<p>Kosto Administrative</p> <p>Donatorë</p>	<p>Trend në rritje vit pas viti i numrit të trajnimeve të organizuara me qëllim ofrimin e njohurive të nevojshme dhe praktikave më të mira koordinatore.</p> <p>Komunikim i vazhdueshëm me kordinatorët e AP qendrore dhe vendore mbi zbatimin e detyrimeve që burojnë nga ligji për të drejtën e informimit.</p> <p>Manual për përdorim nga koordinatorët për të drejtën e informimit, i publikuar.</p> <p>Propozimi për përfitimin e një shtesë page për natyrë të veçantë pune të koordinatorit, i miratuara nëpërmjet ndryshimeve ligjore të propozuara.</p>
2.	Orientimi i autoriteteve publike në qartësimin e çështjeve me interes publik dhe rasteve të kufizimit të	Drejtoria e Përgjithshme e të Drejtës për Informim	6 / II 2022	6 / II 2025	Kosto Administrative	Trend në rritje i numrit të kërkesave për informacion të përmbushura në raport me numrin total të kerkesave.

	dhënies së informacionit, sidomos, përdorimin e konceptit të konfidencialitetit dhe mbrojtjes së te dhënave personale.					
3.	Përfshirja në Indeksin e Transparencës të një numri sa më të madh të autoriteteve publike në nivel qendror dhe të varësisë.	Drejtoria e Përgjithshme e të Drejtës për Informim	6 / II 2022	6 / II 2025	Kosto Administrative	Trend në rritje i numrit të autoriteteve publike që do të përfshihen në Indeksin e Transparencës së Autoriteteve Qendrore dhe të Varësisë.  Indeksi i Transparencës së Autoriteteve Qendrore dhe të Varësisë i hartuar dhe publikuar.
4.	Verifikimi i nivelit të transparencës së institucioneve publike qendrore, të varësisë dhe atyre të vetëqeverisjes vendore.	Drejtoria e Përgjithshme e të Drejtës për Informim	6 / II 2022	6 / II 2025	Kosto Administrative	Trend në rritje vit pas viti i numrit të autoriteteve publike që kanë publikuar në faqet e tyre zyrtare Programin e Transparencës, kontaktet e koordinorit dhe Regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve, në përputhje me përcaktimet e ligjore.  Trend në rritje vit pas viti i numrit të autoriteteve publike që ofrojnë shërbimin e kërkesës për informacion publik dhe ankesës për mos dhënie informacioni, nëpërmjet portalit qeveritar e-Albania.  Trend në rritje vit pas viti i numrit të autoriteteve publike që kanë instaluar Regjistrin elektronik të kërkesave dhe përgjigjeve.

**OBJEKTIVI 3:** Bashkëpunimi me qytetarët dhe grupet e interesit për njohjen e kuadrit të modernizuar ligjor dhe të drejtat që u burojnë nga legjislacioni në fushën e të drejtës për informim.

1.	Zhvillimi i iniciativave ndërgjegjësuese me qëllim njohjen e publikut, shoqërisë civile, grupet e interesit dhe median me kuadrin e ri rregullator.	Zyra e Komisionerit	6 / I 2023	6 / I 2024	Kosto Administrative          Donatorë	Shtrirja e aktiviteteve të zhvilluara në kuadër të iniciativës “Ditët e Transparencës” në të gjitha qarqet e Republikës së Shqipërisë.  Shtrirja e organizimit të “Ditës Ndërkombëtare të së Drejtës për Informim” edhe në qytetet të tjera të Shqipërisë.  Trend në rritje i numrit të personave të trajnuar, përfaqësues të mediave dhe shoqërisë civile.  Broshura, fletëpalosje, video ndërgjegjësuese të publikuara etj.
2.	Zhvillimi i trajnimeve për zbatimin e të drejtës për informim me fokus brezin e ri në bashkëpunim me institucione të arsimit të lartë në gjithë vendin.	Institucionet e Arsimit të Lartë  Zyra e Komisionerit (DPDI)	6 / II 2022	6 / II 2025	Kosto Administrative	Sesione informuese në universitete publike dhe private.  Studentë dhe staf akademik/administrativ i trajnuar.
3.	Dhënie kontributi me ekspertizë teknike që u nevojiten aktorëve të shoqërisë civile, për të përçarur më tej rolin e tyre si watchdog	Drejtoria e Përgjithshme e të Drejtës për Informim	6 / II 2022	6 / II 2025	Kosto Administrative	Trend në rritje i numrit të aktiviteteve të organizuara në bashkëpunim me Organizata jo Fitimprurëse, me qëllim forcimin e zbatimit të të drejtës për informim;  Shëmbim experience, informacionit dhe praktikash.



	të transparencës dhe aksesit në informacion.					
4.	Realizimi dhe publikimi periodik në faqen zyrtare të Zyrës së Komisionerit të materialeve informuese dhe përdorimi i platformave të ndryshme komunikuese.	Drejtoria e Përgjithshme e të Drejtës për Informim  Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Publikun	6 / II 2022	6 / II 2025	Kosto Administrative	Newsletter mujor “E drejta për informim”, e hartuar dhe publikuar.  Materiale informuese dhe ndërgjegjësuese si botimi i revistës, fletpalosjeve, video, spote publicitare të publikuara.
<b>OBJEKTIVI 4:</b> Zhvillimi dhe zgjerimi i marrëdhënieve ndërkombëtare brenda komunitetit global rregullator të së drejtës për informim.						
1.	Organizimi i edicionit të 15 të Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit ( <i>International Conference of Information Commissioners-ICIC</i> ).	Zyra e Komisionerit	6 / I 2024	6 / II 2024	Kosto Administrative  Donatorë	Konferenca Ndërkombëtare e Komisionerëve të Informimit, e organizuar për herë të parë në Shqipëri.  Promovimi i kulturës së transparencës dhe mirëqeverisjes në Shqipëri dhe më gjerë, në rajonin tonë.
2.	Dhënia e kontributit në cilësinë e përfaqësuesit në Këshillin e Palëve të Konventës së Këshillit të Evropës “Për aksesin në dokumente zyrtare”.	Drejtoria e Përgjithshme e të Drejtës për Informim  Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe Integritit	6 / II 2022	6 / II 2025	Kosto Administrative	Raporte, opinione ose propozime të Grupit të Specialistëve të miratuara nga Këshilli i Palëve.

3.	Veprimtari aktive në grupet/bordet e punës të Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve për të Drejtën e Informimit (ICIC), duke punuar ngushtë me partnerët dhe institucionet homologe.	Drejtoria e Përgjithshme e të Drejtës për Informim  Sektori i Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë	6 / II 2022	6 / II 2025	Kosto Administrative  Donatorë	Rol i Zyrës së Komisionerit në planin ndërkombëtar i forcuar.
4.	Zgjerim i bashkëpunimit me autoritetet homologe për shkëmbimin e eksperiencave dhe praktikave më të mira.	Drejtoria e Përgjithshme e të Drejtës për Informim  Sektori i Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë	6 / II 2022	6 / II 2025	Kosto Administrative	Projekte me financimin e fondeve IPA dhe instrumentit TAIEEX të zbatuara.  Marrëveshje bashkëpunimi me autoritetet homologe të nënshkruara dhe zbatuara.

### MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE

**OBJEKTIVI 1:** Arritja e standardeve më të larta rregullatore për të forcuar mbrojtjen e të dhënave personale në epokën digjitale.

1.	Miratimi i projektligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i përafuar me <i>acquis</i> të BE në këtë fushë dhe	Kuvendi	6 / II 2022	6 / II 2023		Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale, i miratuar.  Mbi 12 akte nënligjore të në zbatim të ligjit të ri, të miratuara.
----	--	---------	----------------	----------------	--	---

	akteve nënligjore në zbatim të tij.	Ministria e Drejtësisë  Zyra e Komisionerit			Kosto Administrative	<p>Standarte europiane të zbatuara në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale brënda vitit 2022.</p> <p>Trend në rënie vit pas viti i numrit të ankesave pranë Zyrës së Komisionerit me objekt shkeljen e të drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale nga hyrja në fuqi e ligjit të ri për mbrojtjen e të dhënave personale.</p> <p>Mbikqyrje më efektive e zbatimit të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale nëpërmjet forcimit të rolit të Zyrës së Komisionerit në cilësinë e autoritetit përgjegjës për garantimin e kësaj të drejte.</p> <p>Trend në rritje i numrit të kontrolluesëve publikë dhe/ose privatë që zbatojnë detyrimet e parashikuara nga kuadri i ri ligjor me qëllim rritjen e sigurisë gjatë procesit të përpunimit të të dhënave personale.</p> <p>Garantim i mbrojtjes së të dhënave në lidhje me përpunimin e tyre nga autoritetet kompetente për qëllimet e parandalimit, hetimit, zbulimit ose ndjekjes penale të veprave penale ose ekzekutimin e dënimeve penale, dhe lëvizjen e lirë të të dhënave të tilla.</p>
--	-------------------------------------	---	--	--	----------------------	---



3.	Promovimi i qasjes së re të kontrolluesve dhe përpunuesëve në procesin e përpunimit të të dhënave personale me qëllim garantimin më efektiv të sigurisë së informacionit.	Zyra e Komisionerit	6 / II 2022	6 / II 2025	Kosto Administrative	<p>Rritje të përgjegjshmërisë së kontrolluesve dhe përpunuesve në procesin dinamik të përpunimit të të dhënave personale;</p> <p>Kontrollues të informuar mbi marrjen e masave për:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- kryerjen e vlerësimit të ndikimit në mbrojtjen e të dhënave personale përpara fillimit të një procesi përpunimi;</li> <li>- konsultimin paraprakisht me Komisionerin përpara fillimit të përpunimit të të dhënave, në rast se ky përpunim rezulton me rrezik të lartë për subjektin e të dhënave;</li> <li>- prezantimin e konceptit të mbrojtjes së të dhënave në projektim (by design) dhe mbrojtjes në mënyrë të paracaktuar (by default) si dhe përdorimin e këtyre teknologjive;</li> <li>- hartimin e kodeve të sjelljes për të cilat kanë për qëllim të kontribuojnë në zbatimin sa më të mirë të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale;</li> <li>- njoftimin e Komisionerit në rast cenimi të të dhënave personale, si dhe subjekteve të të dhënave kur rreziqet e shkaktuara nga cenimi i të dhënave mund të të jenë të larta;</li> <li>- ngritjen e mekanizmit të certifikimit, si një instrument i cili demonstroi se një proces përpunimi është në përputhje</li> </ul>
----	---	---------------------	----------------	----------------	----------------------	--



						<p><i>me kuadrin ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale;</i></p> <p>Garantimi më efektiv i sigurisë së informacionit në procesin e përpunimit të të dhënave personale.</p>
4.	Nxjtja e kontrolluesve publik për t'iu drejtuar Zyrës së Komisionerit për dhënien e mendimeve për projekt-aktet, ligjore dhe nënligjore, që kanë të bëjnë me të dhënat personale, si dhe projektet që kërkohen të zbatohen nga kontrolluesit vetëm apo në bashkëpunim me të tjerë.	<p>Drejtoria e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave Personale</p> <p>Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe Integritimit</p>	6 / II 2022	6 / II 2025	Kosto Administrative	<p>Trend rritës i numrit të projekt akteve të konsultuara paraprakisht me Zyrën e Komisionerit duke filluar nga viti 2021.</p> <p>Trend rritës i numrit të akteve të miratuara në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale duke filluar nga viti 2021.</p>
<p><b>OBJEKTIVI 2:</b> Rritja e kapaciteteve institucionale në kuadër të përmirësimeve ligjore, me fokus të veçantë sistemet e sigurisë së menaxhimit të informacionit (SMSI).</p>						
1.	Propozimi i ndryshimeve strukturore të Zyrës së Komisionerit në funksion të kompetencave dhe detyrave të reja që burojnë nga legjislacioni i ri për mbrojtjen e të dhënave personale.	<p>Kuvendi</p> <p>Ministria e Financave dhe Ekonomisë</p> <p>Zyra e Komisionerit</p>	6 / II 2022	6 / II 2025	Kosto Administrative	<p>Reformë strukturore dhe mbështetje buxhetore për Zyrën e Komisionerit.</p>
2.	Pjesëmarrja e stafit në iniciativat dhe rrjetet teknologjike ndërkombëtare dhe evropiane me qëllim	Drejtoria e Përgjithshme për Mbrojtjen	6 / II 2022	6 / II 2025	Kosto Administrative	<p>Staf më i kualifikuar në fushën TIK.</p> <p>Procese të hetimit administrativ të përmirësuara;</p>

	përmirësimin e aftësive të tyre në këtë drejtim.	e të Dhënave Personale			Donatorë	Garantimi i një trajtimi më të mirë i mbrojtjes së të dhënave në lidhje me sfidat e reja të privatësisë që rezultojnë nga përdorimi në rritje i mjeteve teknologjike, si dhe qarkullimit gjithnjë e më të madh të të dhënave personale në botën digjitale.
3.	Identifikimi dhe garantimi i sigurisë teknike në kontrollues publikë dhe privatë me qëllim ruajtjen e konfidencialitetit, integritetit, disponueshmërinë dhe besueshmërinë e sigurisë së informacionit në procesin e përpunimit të të dhënave personale.	Drejtoria e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave Personale	6 / II 2022	6 / II 2025	Kosto Administrative	Reformim i sistemeve të masave të sigurisë të të dhënave nga kontrollues publikë dhe privatë.  Rritje e investimeve nga kontrolluesit publikë dhe privatë jo vetëm për ofrimin e shërbimeve, por edhe për mbrojtjen e tyre.
4.	Krijimi i Rrjetit të nëpunësve për mbrojtjen e të dhënave personale në sektorin publik dhe privat dhe promovimi i dialogut me ta.	Drejtoria e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave Personale	6 / II 2022	6 / II 2023	Kosto Administrative	Rrjeti i nëpunësve për mbrojtjen e të dhënave personale, i konsoliduar.  Rritja e numrit të kontrolluesëve/përpunuesëve që veprojnë në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.
<b>OBJEKTIVI 3:</b> Rol aktiv në ndërgjegjësimin dhe promovimin e të drejtave të qytetarëve me fokus, edhe edukimin e brezit të ri.						
1.	Organizime periodike të trajnimeve, workshop-e me qëllim rritjen e aftësive të kontrolluesve/përpunuesve në zhvillimin me përgjegjshmëri	Drejtoria e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave Personale	6 / II 2022	6 / II 2025	Kosto Administrative	Trend në rritje i numrit të kontrolluesëve/përpunuesëve që veprojnë në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale. Trend në rënie i numrit të vendimeve me sanksion gjobë.

	të proceseve përpunuese të të dhënave personale të qytetarëve.					
2.	Promovimi i legjislacionit të ri të fushës në sistemin arsimor të vendit, me programe të dedikuara për të gjitha grupmoshat, veçanërisht, për fëmijët dhe të rinjtë.	Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar dhe strukturat e varësisë  Zyra e Komisionerit (DPMDHP)	6 / II 2022	6 / II 2025	Kosto Administrative  Donatorë	Shtrirje e Fushatës Kombëtare “Edukimi digjital, luaj dhe mëso – Happy onlife”.  Fletpalosje dhe udhëzues;  Video ndërgjegjësuese;  Rritje e kulturës për ushtrimin e të drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale te brezi i ri.
3.	Përcjellja e njohurive të thelluara akademike për shtimin e numrit të ekspertëve/profesionistëve në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale nëpërmjet bashkëpunimit me institucionet e arsimit të lartë, Shkollën e Magjistraturës dhe Shkollën Shqiptare të Administratës Publike.	Shkolla e Magjistraturës  Shkolla Shqiptare e Administratës Publike  Institucionet e Arsimit të Lartë  Zyra e Komisionerit	6 / II 2022	6 / II 2025	Kosto Administrative	Nëpunës civilë të trajnuar;  Magjistratë të trajnuar;  Studentë dhe staf akademik/administrative, të trajnuar.  Trend në rritje i numrit të ekspertëve/profesionistëve në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale.

4.	Hartimi i materialeve ndërgjegjësuere për promovimin e kulturës në ushtrimin të drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale nga qytetarët.	Zyra e Komisionerit	6 / II 2022	6 / II 2025	Kosto Administrative	Materiale informuese dhe ndërgjegjësuere (revistë; fletpalosje; video) të hartuara dhe/ose të publikuara.  Qytetarë më të ndërgjegjësuar në ushtrimin e kësaj të drejte.
<b>OBJEKTIVI 4:</b> Forcimi i bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtarë për shkëmbimin e përvojave më të mira, me fokus risitë që sjell zbatimi i legjislacionit të harmonizuar me <i>acquis</i> të BE.						
1.	Zgjerimi i bashkëpunimit me autoritetet homologe dhe/ose organizmat ndërkombëtare për projekte në kuadër të shkëmbimit të praktikave/standardeve më të mira në këtë fushë.	Drejtoria e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.  Sektori i Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë.	6 / II 2022	6 / II 2025	Kosto Administrative  Donatorë	Projekte me financimin e fondeve IPA dhe instrumentit TAIEEX të zbatuara;  Marrëveshje bashkëpunimi me autoritetet homologe të nënshkruara dhe zbatuara.
2.	Forcimi i kapaciteteve administrative në shqyrtimin e praktikave në lidhje me transferimin ndërkombëtar të të dhënave personale.	Drejtoria e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave Personale	6 / II 2022	6 / II 2025	Kosto Administrative	Procese të trajtimit të praktikavë për transferimin ndërkombëtar të përmirësuar;  Garantim i mbrojtjes së të dhënave personale nga rreziqet e shtuara që mund të paraqesë transferimi ndërkombëtar.
3.	Konsolidimi i marrëdhënieve, shkëmbimit të eksperiencave dhe njohurive praktike në kuadër të ligjit nr. 113/2018 "Për ratifikimin e	Drejtoria e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave Personale	6 / II 2022	6 / II 2025	Kosto Administrative	Vizitë studimore në kuadër të " <i>Përftimit të asistencës në hartimin e një metodologjie të monitorimit dhe raportimit në lidhje me aspektet e mbrojtjes së të dhënave personale në kuadër të zbatimit të</i>

	marrëveshjes për bashkëpunimin ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Eurojust-it".				Instrumenti TAIEX	<i>Marrëveshjes Eurojust- Shqipëri</i> ", e kryer. Raport në kuadër të përmbushjes së detyrimit të nenit 19 Marrëveshjes së Bashkëpunimit me Eurojust, i hartuar.
4.	Pjesëmarrje aktive në forume e iniciativa për promovimin e dialogut ndërkombëtar për mbrojtjen e të dhënave dhe privatësisë.	Drejtoria e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave Personale	6 / II 2022	6 / II 2025	Kosto Administrative	Pjesëmarrje aktive në të gjitha forumet si:  <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Asambleja Globale e Privatësisë (GPA), Komiteti Ekzekutiv, Nënkomiteti i Drejtimit Strategjik (SDSC).</i></li> <li>• <i>Konferenca e Autoriteteve Evropiane të Mbrojtjes së të Dhënave dhe Grupi i Punës për të Ardhmen e Konferencës Evropiane;</i></li> <li>• <i>Bordi Evropian i Mbrojtjes së të Dhënave.</i></li> <li>• <i>Komiteti Konsultativ i Konventës 108 (Komiteti TPD).</i></li> <li>• <i>Grupi Ndërkombëtar i Punës për Mbrojtjen e të Dhënave në Telekomunikacione (Grupi i Berlinit) etj</i></li> </ul> <p>Forcim kapacitetesh nëpërmjet shkëmbimit të eksperiencave, informacionit dhe praktikave më të mira.</p>